REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 15040 Vendimi.

15040

# V E N D I M
## PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot, me daten 31.05.1996, ne Gjykaten e Rrethit Tirane, une Flororiq Tçoli gjyqtare e kesaj gjykate, pasi u njoha me materialet e paraqitura nga Thodhoraq Bendo Pashaj, i lindur me 1950 ne Vlore dhe banues ne Rr.Aranit Serbi, pall.1217 Vlore dhe Alban Azbi Çela i lindur me 1952 ne Vlore dhe banues ne Rr.Sitki Çiço, pall.6 ap.19 Tirane per te bere regjistrimin si person juridik te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "JON-ALB-FLORES";

## K O N S T A T O V A

Kerkuesit Thodhoraq Pashaj dhe Alban Çela, te dy ortak kane themeluar Shoqerin me Pergjegjesi te Kufizuar "JON-ALB-FLORES", me Seli ne lagjen "Rilindja", Rr."Aranit Serbi", pall.1217 Vlore dhe me te drejte per ta ushtruar aktivitetin e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj, me kohe zgjatje mbi 10 vjet, me kapital themeltar 100.000 leke, i vene me kontributet e barabarta te dy ortakeve nga 50 % Thodhoraq Pashaj dhe 50 % Alban Çela, po keshtu do te ndahen edhe fitimet nga 50 % Thodhoraq Pashaj dhe 50 % Alban Çela, me Administrator THODHORAQ BENDO PASHAJ dhe me aktivitet qe konsiston: Ne fushen e projektimit, zbatimit e sherbimit ne siperfaqet e gjelberuara dhe ato urbane ne qytete,komuna dhe familjare; import export per prodhimin dhe tregetimin me shumice e pakice te bimeve dekorative, industriale e medicinale, te farerave te ndryshme te tyre etj; import export per tregetimin me shumice e pakice te artikujve te ndryshem bujqesor, blektoral, ushqimor, industrial etj; ne fushen e transportit te brendshem e te jashtem per turizem ne qendrat pushuese e klimaterike si dhe transportin e mallrave te permendura me siper me mjetet e shoqerise ose te marra me qera.

Meqense kerkesa e tyre per regjistrimin e kesaj shoqerie si person juridik eshte e drejte si e till ajo duhet pranuar.

## PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit Nr.7638, date 19.XI.1992 dhe nenit 33 te Ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993;

## V E N D O S A

Regjistrimin si person juridik te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufi-

zuar "JON-ALB-FLORES", me ortake Thodhoraq Bendo Pashaj dhe Alban Azbi Çela, me Seli ne legjen "Rilindja", Rr."Aranit Serbi", pall.1217 Vlore dhe me te drejte per ta ushtruar aktivitetin e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj, me kohezgjatje mbi 10 vjet, me kapital themeltar 100.000 leke i vene me kontributet e barabarta te dy ortakeve nga 50 % Thodhoraq Pashaj dhe 50 % Alban Çela, po keshtu do te ndahen dhe fitimet nga 50 % Thodhoraq Pashaj dhe 50 % Alban Çela, me Administrator Thodhoraq Bendo Pashaj dhe me aktivitet qe konsiston ne fushat me projektimit, zbatimit e sherbimit ne siperfaqet e gjelberuara dhe ato urbane ne qytete, komuna e familjare; import export per prodhimin dhe tregetimin me shumice e pakice te bimeve dekorative, industrial e medicinale, te farerave te ndryshme te tyre etj; import export per tregetimin me shumice e pakice te artikujve te ndryshem bujqesor, blektoral ushqimor, industrial etj; ne fushen e transportit te brendshem e te jashtem per turizem ne qendrat pushuese e klimaterike si dhe transportin e mallrave te permendura me siper me mjetet e shoqerise ose te marra me qera.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne shkallen e dyte.

G J Y Q T A R E

Florenia Tepeli

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR. 15040/1 Vendimi

**V E N D I M**
**( I GJYQTARIT TE VETEM)**

Sot, me daten 12 Janar 2001, ne Gjykaten e Rrethit Tirane, une gjyqtare e vetme Fegjine Sollaku, mbasi shqyrtova materialet e paraqitura nga Theodhoraq Bendo Pashaj, lindur me 1950 ne Vlore dhe banues ne Rr."Aranit Serbi", pallati 1217 Vlore dhe Alban Azbi Çela, lindur me 1952 ne Vlore dhe banues ne Rr. "Sitki Cico, pall. 6, shk.2, ap.19, Tirane, per depozitimin e vendimit te asamblese se ortakeve te Shoqerise "JON ALB FLORES" shpk Vlore per te bere disa ndryshime ne aktivitetin e kesaj shoqerie;

**K O N S T A T O V A**

Me vendimin Nr.15040, date 31.05.1996, te Gjykates se rrethit Tirane, eshte rregjistruar si person juridik Shoqeria "JON ALB FLORES" shpk me ortak Theodhoraq Pashaj dhe Alban Çela, me seli ne Rr. "Aranit Serbi", pall 1217 Vlore, me kohezgjatje mbi 10 vjet, me kapital 100.000 leke, me administrator Theodhoraq Bendo Pashaj dhe me aktivitet ne fushen e projektimit, zbatimit e sherbimit ne siperfaqet e gjelberuara dhe ato urbane ne qytet, komuna, familjare etj. te parashikuara ne vendimin e me siperm te gjykates.

Me vendimin Nr.1, date 10.01.2001 te ortakeve themelues te kesaj shoqerie eshte vendosur te behet shtese aktiviteti ne keto drejtime:

*Ne fushen e ndertimit, punime dheu, sistemime, taracim terrenesh, prodhim materiale inerte, rere, cakull, mermer; prodhime elementesh te parafabrikuara, betonim, beton arme, prodhime druri, metalike, plastike, per dyer, dritare, kallepe etj; ndertime civile dhe ekonomike, rikonstruksion godina civile, ekonomike, veshje fasadash etj si dhe mirembajtje dhe zhvillimi i dekoreve ne mjediset urbane.* Selia, kohezgjatja, kapitali dhe administratori i shoqerise nuk ndryshojne.

Meqenese kerkesa e tyre per te bere ndryshimet e me siperme eshte e drejte, si e tille ajo duhet pranuar.

**P E R K E T O A R S Y E :**

Ne baze te nenit 33 te Ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993;

## V E N D O S A :

-Pranimin e kerkeses te ortakeve te Shoqerise "JON ALB FLORES" shpk Vlore Theodhoraq Bendo Pashaj dhe Alban Azbi Çela.

-Depozitimin ne Zyren e Rregjistrit Tregetar te Vendimit Nr. 1, date 10.01.2001 te asamblese se ortakeve te kesaj shoqerie, per te bere ndryshimet e me siperme, per shtese ne aktivitetin e saj.

-Urdherimin e zyres se Rregjistrit Tregetar te beje ndryshimet perkatese ne kolonen 2-c, 4 dhe 5 me numer rendor 2.

-Ndarjen me vize te kuqe ne rregjister te ndryshimeve te bera.

G J Y Q T A R E

Regjine Sollaku
H. Sollaku

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES PARE TIRANE
Nr. 15040/12. Vendimi.

V E N D I M
( I GJYQTARIT TE VETEM )

Sot, me daten 5/3/ 2004, ne Gjykaten e Shkalles Pare Tirane, une gjyqtare e vetme R. Rongoja e kesaj gjykate, mbasi shqyrtova materialet e paraqitura nga Thodhoraq Bendo Pashaj, lindur me 1950 ne Vlore dhe banues ne Rr.Aranit Serbi, pall.1217 Vlore dhe Alban Azbi Çela, lindur ne 1952 ne Vlore dhe banues ne Rr.Sitki Çiço , pall.6 shk.2 ap.19 Tirane, per depozitimin e vendimit Nr.2 te ortakeve themelues te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar " JON-ALB-FLORES" shpk Vlore per te bere disa ndryshime ne kete shoqeri;

K O N S T A T O V A

Me vendim Nr.15040, date 31.05.1996te Gjykates se Shkalles Pare Tirane eshte regjistruar si person juridik Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar " JON - ALB - FLORES " shpk Vlore me ortak Thodhoraq Pashaj dhe Alban Çela, me seli ne lagjane "Rilindja", Rr.Aranit Serbi" pall.1217 Vlore dhe me te drejte per ta ushtruar aktivitetin e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj, me kohezgjatje mbi 10 vjet, me kapital themeltar 100.000 leke dhe me Administrator Thodhoraq Bendo Pashaj dhe me aktivitet ekonomik siç eshte parashikuar ne vendimin e Gjykates dhe me vone me Vendim Nr.15040/1, date 12.01.2001 te po kesaj Gjykate eshte bere plotesimi i aktivitetit siç eshte parashikuar ne te.

Me vendim Nr.2, date 16.02.2004 te ortakeve themelues te kesaj shoqerie eshte vendosur te behen ndryshimet e me poshteme:

Ortaku Alban Çela ka vendosur te largohet nga kjo shoqeri dhe per kete ai i ka shitur kuotat e tij te kapitalit themeltar te shoqerise qe jane 50 % dhe me vlente 50.000 leke ortakut tjeter Thodhoraq Pashaj i cili pas kesaj behet ortak i vetem i kesaj shoqerie dhe posedues i te tere kapitalit themeltar te kesaj shoqerie prej 100.000 leke.

Emeri i shoqerise, kohezgjatja e aktivitetit te saj, objekti i veprimtarise, selia e saj dhe Administratore e kapitali i saj nuk ndryshojne.

Megjenese kerkesa e tyre per te bere ndryshimet e me siperme eshte e drejte, si e tille ajo duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te nenit 53 te Ligjit Nr.7667, date 28.01.1993

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses te ortakeve te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "JON - ALB - FLORES " shpk Vlore Thodhoraq Pashaj dhe Alban Azbi Çela.

Depozitimin ne Zyren e Rregjistrit Tregetar te Vendimit Nr.2, date 16.02.2004 te ortakeve themelues te kesaj shoqerie, per te bere ndryshimin e me siperm, per shitjen e kuotave te kapitalit nga ortaku Alban Çela tek ortaku tjeter Thodhoraq Bendo i cili pas kesaj behet ortak i vetem i kesaj shoqerie, sipas kontrates se shitjes me nr;53 rep. dhe nr;6 kol; datë 16.02.2004 të noterit Perlat Kasaj.

Urdhërimin e Zyrës së Regjistrit Tregtar të bëjë ndryshimet përkatëse në kolonën nr;2, germa "c", 4 dhe 5 me numer rendor 2.

Të ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vijë të kuqe.

GJYQTARE

Koleta Pauajoh

(15040)

Urdhër regjistrimi

1. Nr
2. (a) "Jon-Alb-Flores" sh.p.k.
(b) imp. eks mall të +
(c) Rr "A Serbi" pall 1217 Vlorë
(ç) 100 000 lekë
3. Adm ë z. Thodhoraq Pashoj
Statuti ka 7 fletë dhe
është nënshkruar 31.5.1996
Adm ë i vetëm.
Adm 31.5.1996.
Dt 31.5.1996.

Gjygjtar
[signature]

Av. Perlat Kasaj
Dhoma. E Avokatise
Tirane
RR. »E Durresit« Nr. 37

NOTERE
TIRANE

# KONTRATE

## PER THEMELIMIN E SHOQERISE "JON-ALB-FLORES" SHPK

Sot, me daten 31.05.1996, ketu ne Vlore ne ortaket:

1. THODHORAQ BENDO PASHAJ, i lindur me 1950 ne Vlore dhe banues ne Lagjen "Rilindja",Rr."Aranit Serbi", pall.1217 Vlore.

2. Alban AZBI ÇELA, i lindur me 1952 ne Vlore dhe banues ne Rr.Sitki Çiço, pall.6 shk.2 ap.19 Tirane.

Kemi themeluar shoqerine me pergjegjesi te kufisuar "JON-ALB-FLORES".

### NENI 1

Midis subjekteve te mesiperm themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufisuar e quajtur "JON-ALB-FLORES" shpk IMPORT - EXPORT.

### NENI 2

Shoqeria e ka Seline e saj ne Lagjen "Rilindja", Rr."Aranit Serbi", pall.1217 Vlore dhe me te drejte per ta ushtruar aktivitetin e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

### NENI 3

Kohesgjatja e aktivitetit ekonomik te shoqerise eshte mbi 10 vjet dhe mund te shperbehet ne çdo kohe.

### NENI 4

Shoqeria ka per objekt te aktivitetit te saj:

- Ne fushat e projektimit, zbatimit e sherbimit ne siperfaqet e gje boruara dhe ato urbane ne qytete, komuna dhe familjare.
- Import Export per prodhimin dhe tregetimin me shumice e pakice te bimeve dekorative, industriale e medicinale, te fareave te ndryshme te tyre etj.
- Import Export per tregetimin me shumice e pakice te artikujve te ndryshem bujqesor, blektoral, ushqimor, industrial etj.
- Ne fushen e transportit te brendshem e te jashtem per turizem ne qendrat pushuese e klimaterike si dhe transportin e mallrave te permendu ne siper me mjetet e shoqerise ose te marra me qera.

NOTERE TIRANE

NENI 5

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke i ndare ne kuotat 50 % dhe 50 % secili e merret persiper dhe nenshkruhet si me poshte:

1. THODHORAQ PASHAJ 50 %

2. ALBAN ÇELA 50 %

Kapitali duhet te derdhet plotesisht prane nje banke apo te jete i depozituar prane nje notori.

Neni 6

Shoqeria do te Administrohet nga nje Administrator i vetem. Administratori i vetem emerohet Thodhoraq Bendo Pashaj qe pranon detyren, i cili do te kryej modifikimet apo te heqi çdo gje qe eventualisht do t'i kerkohet ne rastin e regjistrimit te shoqerise.

NENI 7

Palet do te kene nje pjesmarrje ne fitimin e shoqerise ne masen e pjesmarrjes se tyre ne kapitalin e shoqerise. Palet mbeten gjithashtu pergjegjese per detyrimet e shoqerise ne kufijte e kapitalit te marr persiper.

NENI 8

Palet kane te drejte te heqin dore nga shoqeria kur kane motive te drejta per kete por, duke paralajmeruar shoqerine dy muaj perpara.

NENI 9

Çdo mosmarveshje qe mund te lindi midis ortakeve do te zgjidhet miqesisht dhe ne munges te nje marrveshje, instanca kopetente do te jete gjykata e rrethit Tirane.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

1. THODHORAQ PASHAJ

2. ALBAN ÇELA

AÇela

# STATUTI

## I SHOQERISE "JON-ALB-FORES" SHPK

### KREU I

### EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA DHE AKTIVITETI

#### Neni 1

Shoqeria emertohet "JON-ALB-FLORES" sh.p.k. IMPORT - EXPORT.

Ajo eshte person juridik dhe zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me aktin e themelimit, normat e ketij statuti dhe gjithmon ne zbatim te legjislacionit ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

#### Neni 2

Shoqeria e ka Seline e saj ne Lagjen "Rilindja", Rr."Aranit Serbi", pall.1217 Vlore dhe me te drejte per ta ushtruar aktivitetin e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

#### Neni 3

Kohezgjatja e aktivitetit ekonomik te shoqerise eshte mbi 10 vjet dhe mund te shperbehet ne çdo kohe me vendim te Asamblese se ortakeve.

#### Neni 4

Objketi i veprimtarise ekonomike te shoqerise konsiston:

- Ne fushat e projektimit, zbatimit e sherbimit ne siperfaqet e gjelberuara dhe ato urbane ne qytete, komuna dhe familjare.
- Import Export per prodhimin dhe tregotimin me shumice e pakice te bimeve dekorative, industriale e medicinale, te fareave te ndryshme te tyre etj.
- Import Export per tregotimin me shumice e pakice te artikujve te ndryshem bujqesor, blektoral, ushqimor, industrial etj.
- Ne fushen e transportit te brendshem e te jashtem per turizem ne qendrat pushuese e klimaterike si dhe transportin e mallrave te permendur me siper me mjetet e shoqerise ose te marra me qera.

#### Neni 5

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, vendqendrimin dhe objektin e

veprimtarise se saj sipas vendimeve te Asamblese se ortakeve, pronar te shoqerise.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR

Neni 6

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 leke ne natyre i ndare ne kuotat 50 % e 50 % secili dhe merret persiper e nenshkruhet si me poshte:

1. THODHORAQ PASHAJ 50 %
2. ALBAN ÇELA 50 %

Neni 7

Kuotat e kapitalit mund te shiten midis ortakeve sipas vleres se pergjithshme te realizuar deri ne ate moment nga shoqeria.

Ofertat behen ne perputhje me kuotat e poseduara nga çdo ortak dhe ju behet e njohur me shkrim ortakeve qe jane te regjistruar ne librin e ortakeve, duke lene nje kohe maksimale prej 50 ditesh per te vendosur.

Me te skaduar ky afat, ortaku shites ka te drejte te shese kuoten te treteve gjithmon me aprovimin paraprak te Asamblese se ortakeve. Ne çdo rast ortaku shites ka te drejte ne shoqeri t'i nenshkrohet miratimit paraprak te Asamblese e cila ka nje kohe ne dispozicion prej 30 ditesh per t'u shprehur dhe ne rast mospergjigje brenda ketij afati miratimi quhet i dhene.

Kuotat e kapitalit, ne rast vdekje, i kalohen trashegimtareve duke hyre keta te fundit ne te gjitha te drejtat e ortakut.

KREU III

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Neni 8

Organet drejtuese te shoqerise jane Asambleja e ortakeve dhe Administratori.

Asambleja e shoqerise perbehet prej te dy ortakeve themelues Thodhoraq Bendo/Pashaj dhe Alban Asbi Çela.

Asambleja e ortakeve ka emeruar si Administrator THODHORAQ BENDO PASHAJ, qe e pranon detyron, i cili veç te tjerave eshte i autorizuar

te kryoj ne kete statut te gjitha ndryshimet, modifikimet apo te hegi çdo gje qe eventualisht do t'i kerkohet me rastin e regjistrimit te shoqerise.

Asambleja e Shoqerise eshte organ sovran i saj, ku ortaket qeverisin veprimtarine e shoqerise duke u mbeshtetur ne te drejten e tyre te prones private dhe mjeteve te investuara ne shoqeri.

Vendimet qe merr Asambleja jane te detyrueshme per te gjithe ortaket themelues te shoqerise.

Neni 9

Asambleja eshte e zakonshme dhe e jashtezakonshme.

Ajo mblidhet ne formen e jashtezakonshme:

a) Per te bere ndryshime ne statutin e shoqerise.

b) Per te vendosur rritjen ose uljen e kapitalit te shoqerise.

c) Per te kaluar ne likujdimin e parakoheshem te shoqerise ose per te zgjatur afatin.

Asambleja zhvillon mbledhjen e zakonshme per te miratuar programin ekonomik te shoqerise per vitin e ardheshem (dhjetor) dhe per te miratuar bilancin kontabel per vitin e me parshem.

KREU IV

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 10

Shoqeria "JON-ALB-FLORES" deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky statut si dhe ato te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Neni 11

Shoqeria fiton zotesin per te vepruar me regjistrimin e saj si person juridik ne Gjykaten e Rrethit Tirane, ndersa e ushtron aktivitetin privat me regjistrimin e saj ne organet tatimore te rrethit te Vlores.

Neni 12

Emeri i shoqerise, kapitali i saj themelor si dhe emeri i Administratorit duhet te figurojne ne te gjitha aktet qe nxier dhe ju dergon te treteve shoqeria.

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtjen: SHOQERIA "JON-ALB-FLORES" sh IMPORT - EXPORT VLORE ALBANIA.

Neni 13

Shoqeria vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejta dhe detyrimet kontraktore e jashte kontraktore.

Themeluesit mbartin resikun per veprimtarin e shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve te investuara ne shoqeri.

Neni 14

Pronaret e shoqerise si dhe Administratori i emeruar nga Asambleja e shoqerise jane te veshur me te gjitha fuqite per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise pa asnje kufisim. Ata kane mundesi te kryejne te gjitha aktet qe konsiderohen te nevojshme per arritjen e qellimeve te shoqerise. Ata kane te drejte midis te tjerash te lidhen me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja, duke siguruar pjesmarrje per qellime te veprimtarive ekonomike te permendura ne nenin kater te ketij statuti. Kryejne çdo lloj veprimi ndaj te gjitha zyrave shtetrore e private qe kane te bejne me garancite e veprime ipotekore, kryejne prane instituteve bankare dhe financiare veprime depozitimi, kreditimi, pagesa e arketime per llogari te shoqerise apo te te treteve.

Ne rate te tilla Administratori i emeruar ka per detyre te njoftoje dhe t'i japi llogari Asamblese se shoqerise duke mbajtur pergjegjesi civile dhe penale ne kryerjen e detyrave te ngarkuara.

KREU V

MARDHENIET E PUNES

Neni 15

Mardheniet e punes ne shoqeri regullohen nepermjet kontrates se punes. Per çeshtje qe nuk regullohen me kontrate pune, zbatohen dispositat perkatese te legjislacionit ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

Neni 16

Shoqeria merr persiper te respektoj rregullat ne fuqi te punesimit dhe te sigurimeve shoqerore per te gjithe te punesuarit ne shoqeri, ndersa keta te fundit jane te detyruar te pranojn kete statut.

Neni 17

Te punesuarit ne shoqeri pergjigjen perpara ligjit dhe sipas ketij

statuti per moszbatimin e detyrave te ngarkuara dhe per demtimet qe i shkaktojne shoqerise, civilisht dhe penalisht.

Neni 18

Te gjithe te punesuarit ne shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes ne shoqeri.

Detyra e ruajtjes se sekretit te punes nga te punesuarit ne shoqeri, vazhdon edhe mbas largimit te tyre nga kjo shoqeri.

KREU VI

PERFQAESIMI I SHOQERISE

Neni 19

Perfaqesimi i shoqerise i perket Asamblese se ortakeve themelues dhe Administratorit te emeruar prej saj.

KREU VII

KONTROLLI I BRENDESHME

Neni 20

Shoqeria kontrollin e brendshem e organizon me ekspert kontabel te autorizuar, te emeruar ne ose paafat te caktuar. Ekspertet kontabel kontrollojne dhe garantojne qe llogarite vjetore jane te rregullat dhe qe japin nje pasqyrim te sakt te resultateve te operacioneve te vitit te mbaluar financiar, te gjendjes financiare dhe te trashegimise se shoqerise ne fund te vitit financiar. Ata kontrollojne pershtatjen e kontabilitetit te shoqerise me detyrimet e pergjithshme, parimet dhe rregullat e mbajtjes se kontabilitetit, percaktuar ne Ligjin Nr.7651, date 19.01.1993 "Per kontabilitetin". Ata jane pergjegjes ndaj shoqerise dhe te treteve per pasojat e demshme qe rrjedhin nga fajet dhe nenevlersimet e tyre ne ushtrimin e funksjoneveperkatese.

KREU VIII

BILANCI DHE TE ARRDHURAT

Neni 21

Veprimet ekonomike dhe financiare te shoqerise, mbyllen me 31 dhje

te çdo viti, perveç urdherave te veçanta qe jep Asambleja e Shoqerise. Ne fund te çdo periudhe ushtrimore Administratori nxjer bilancin kontabel te shoqerise me rezultatin ekonomik HUMBJE - FITIM si dhe harton raport me shkrim.

Raporti i Administratorit, inventaret, bilanci dhe llogarite vjetore te hartuara nga Administratori, i nenështrohen miratimit nga Asambleja e shoqerise brenda nje afati prej tre muajve nga data e mbylljes te vitit financiar.

Neni 22

Te arrdhurat neto, pas veçimit te fondit te akumulimit, fondeve reserve, pagimeve te detyrimeve fiskale, ju ndahen ortakeve te shoqerise ne mase te barabarte siç eshte edhe kuota e tyre ne formimin e kapitalit te shoqerise.

KREU IX

SHPERBERJA E SHOQERISE

Neni 23

Shperberja e shoqerise mund te vije ne çdo kohe dhe per çfardo shkaku si, ne raste falimentimi, privim te te drejtave per te ushtruar veprimtari tregetare etj. Ne keto raste, ASambleja e shoqerise vendos mbi menyrat e likujdimit, duke caktuar nje ose me shume likujdator.

Ne rastin e likujdimit te shoqerise emertimi i saj do te pasohet nga shenimi : SHOQERI NE LIKUJDIM E SHPER.

Mbasi behet njoftimi i mbylljes ose i likujdimit dhe kryhen formalitetet perkatese, shoqeria çregjistrohet nga regjistri tregetar.

KREU X

DISPOZITAT E PERGJITHSHME

Neni 24

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut i referohet plotesimeve qe do te behen nga Asambleja e shoqerise si dhe legjislacionit shqiptare ne fuqi.

Neni 25

Ky statut perpilohet ne disa kopje me fuqi te barabarte sejcila

per t'ju shperndare organeve kopetente qe e kerkon ligja, ndersa nje kopje mbetet si pjese perberse e dokumentacionit te themelimit te shoqerise.

Statuti hyne ne fuqi diten e nxierjes se tij nga ortaket themelues te shoqerise, i firmosur prej tyre perpara nje noteri.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

1. THODHORAQ PASHAJ

2. ALBAN ÇELA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 4342 rep.
Nr. 1566 kol.

V E R T E T I M

Sot, me daten 31.05.1996, u paraqiten ne Dhomen e Noterise Tirane, Thodhoraq Pashaj banues ne Vlore dhe Alban Çela banues ne Tirane te dy madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identietin e te cileve u sigurova nga letermjoftimet e tyre personale te cilet me deklaruan se kontrata e themelimit dhe statuti i shoqerise "Jon-Alb-Flores" shpk Vlore eshte hartuar ne perputhje me vullnetin e tyre dhe e nenshkruajten ate para meje. Sipas ligjit dhe une noterja e vertetoj ate rregullisht.

N O T E R E
Kimete Peza

15040/2

24 SHKURT 2004

K E R K E S E

E

1. ALBAN AZBI ÇELA, lindur me 1952 ne Vlore dhe banues ne Rr.Sitki Cico, pall.6 shk.2 ap.19 Tirane

2. THODHORAQ BENDO PASHAJ, lindur me 1950 ne Vlore dhe banues ne Rr. Aranit Serbi, pall.1217 Vlore

ME OBJEKT : Depozitimin prane Regjistrit Tregetar te Gjykates Shkalles Pare Tirane te Vendimit Nr.2 date 16.02.2004 te ortakeve te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar " JON - ALB - FLORES " shpk Vlore.

GJYKATES SHKALLES PARE

T I R A N E

Ne kerkuesit Alban Çela dhe Thodhoraq Pashaj te dy ortak te Shoqeris me Pergjegjesi te Kufizuar " JON - ALB - FLORES ", e cila eshte regjist-ruar si person juridik me vendim Nr.15040, date 31.05.1996 te Gjykates S Shkalles Pare Tirane, me seli ne lagjen "Rilindja", Rr.Aranit Serbi" pa-llati 1217 Vlore dhe me te drejte per ta ushtruar kete aktivitet ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj, me kohezgja tje mbi 10 vjet, me kapital themeltar 100.000 leke i vene me kontribute e barabarta te dy ortakeve nga 50 % dhe 50 % sejcili dhe po kethu do te ndahen edhe fitimet nga 50 % dhe 50 % sejcili, me Administrator Thodho Bendo Pashaj dhe me aktivitet ekonomik sic eshte parashikuar ne vendim e kesaj gjykate dhe plotesuar me vendim Nr.15040/1, date 12.01.2001 te po kesaj gjykate.

Me vendim Nr.2 date 16.02.2004 te ortakeve te me siperm eshte ve-ndosur te behen plotesimet e me poshteme:

- Ortaku Alban Çela largohet nga kjo shoqeri duke i shitur kuota e tij prej 50 % dmth 50.000 (leke pesdhjemije) ortakut tjeter Thodhor Bendo Pashaj i cili pas kesaj behet ortak i vetem i kesaj Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar "JON-ALB-FLORES" shpk Vlore

Meqense kerkesa tone eshte ne perputhje te plote me legjislacio ne fuqi te Republikes se Shqiperise, kerkojm qe te behen ndryshimet mesiperme ne Regjistrin Tregtar te kesaj gjykate.

K E R K U E S I T

ALBAN AZBI ÇELA

THODHORAQ BENDO PASHAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 53 rep.
Nr. 6 kol.

KONTRATE - SHITJE

Sot, me daten 16.02.2004, para meje Noterit Perlat Kasaj u paraqiten palet e me poshteme te cilet me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje sa me poshte vijon:

SHITESI : Alban Azbi Çela, lindur me 1952 ne Vlore dhe banues ne Rr. Sitki Çiço, pall.6 shk.2 ap.19 Tirane, paisur me leternjoftimi Nr.UG 406-885, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

BLERESI : Thodhoraq Bendo Pashaj, lindur me 1950 ne Vlore dhe banues ne Rr.Aranit Serbi, pall.1217 Vlore, paisur me certifikat lindje Nr.4/47 madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Palet jane marr vesh si me poshte:

Shitesi Alban Çela eshte ortak me bleresin Thodhoraq Pashaj ne Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar "JON-ALB-FLORES" me seli ne qytetin e Vlores dhe me nje kapital themeltar prej 100.000 (njeqindemije) leke te vene me kontributin e barabarte prej 50 % dhe 50 % sejcili qe konvertohet me 50.000 (pesdhjetmije) dhe 50.000 (pesdhjetmije) leke te reja nga Alban Çela dhe Thodhoraq Pashaj. Meqense shitesi Alban Çela kerkon largimin e tij nga kjo shoqeri ka vendosur qe kuotat e tij prej 50 % qe kapi shumen prej 50.000 (pesdhjemije) leke te reja t´ja shesi ortakut tjeter bleresit Thodhoraq Pashaj i cili pas kesaj behet pronar i gjithe kapitalit te kesaj shoqerie prej 100.000 (njeqindmije) leke te reja dhe njekohesishte betet ortak i vetem i kesaj shoqerie e cila nuk ndryshon emerin e saj, selin, administratorin dhe aktivitetin e kesaj shoqerise te percaktuar ne Vendimet e Gjykates se Shkalles Pare Tirane Nr.15040 dhe vendimit Nr.15040/1 e para date 31.05.1996 dhe e dyta date 12.01.2001.

Kjo kontrate u redaktua ne tre kopje me fuqi te barabarte sejcila dhe pasi lexohet me ze neneshkruhet nga palet para meje noterit Perlat Kasaj i cili pasi verifikova identitetin e tyre e vertetoj edhe une rregullisht.

| SHITESI | BLERESI | NOTER |
|---|---|---|
| ALBAN AZBI ÇELA | THODHORAQ PASHAJ | PERLAT KASAJ |

V E N D I M

Nr.2

I ORTAKEVE TE SHOQERISE"JON-ALB-FLORES"

Sot, me daten 16.02.2004 ne ortaket Alban Çela dhe Thodhoraq Pashaj te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "JON-ALB-FLORES", mbasi analizuam punen e deritanishme te shoqerise dhe marrjen e masave te me-tejshme per ecurin e aktivitetit te kesaj shoqerie,

V E N D O S E M

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "JON - ALB - FLORES " eshte regjistruar si person juridik me vendimin Nr.15040, date 31.05.1996 te Gjykates se Shkalles Pare Tirane per zhvillimin e nje aktiviteti qe para-shikohet ne kete vendim dhe eshte plotesuar aktiviteti i saj me Vendimin Nr.15040/1, date 12.01.2001 te po kesaj gjykate. Aktiviteti i saj i deri tanishem ka qene konform ligjeve ne fuqi te Republikes se Shqiperis.

Meqense ortaku Alban Çela kerkon te largohet nga kjo shoqeri per arsye personale kuotat e tij ai ja shet ortakut tjeter Thodhoraq Pashaj qe kapin shumen prej 50.000 (pesdhjetmije) leke te reja i cili pas kesaj behet pronar i gjithe kapitalit themeltar te shoqerise dhe mbetet ortak i vetem i kesaj shoqerie.

Selia, kapitali, administratori dhe aktiviteti i Shoqerise me Per-gjegjesi te Kufizuar " JON - ALB - FLORES " nuk ndryshojne.

Kopjen e ketij vendimi per plotesimin e me siperm, mbasi te nene-shkruhet prej te dy ortakeve para nje noteri, te depozitohet ne Regji-strin Tregetar te Gjykates se Shkalles Pare Tirane dhe ne zyren e Tati-meve te rrethit Vlore.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

ALBAN AZBI ÇELA

THODHORAQ BENDO PASHAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 53 rep.

V E R T E T I M

Sot, me daten 16.02.2004, para meje Noterit Perlat Kasaj u paraq Alban Azbi Çela, lindur me 1952 ne Vlore dhe banues ne Rr,Sitki Cico, 6 shk.2 ap.19 Tirane, paisur me leternjoftimi UG Nr.406885 dhe Thodho Bendo Pashaj, lindur me 1950 ne Vlore dhe banues ne Rr.Aranit Serbi, 1217 Vlore, paisur me certifikat lindje Nr.4/47 te dy madhor dhe me

15040

Av. Perlat Kasaj
Dhoma. E Avokatise
Tirane
RR. »E Durresit« Nr. 37

# K E R K E S E

e

1.THODHORAQ BENDO PASHAJ,i lindur me 1950 ne Vlore dhe banues ne Lagjen Rilindja, Rr.Aranit Serbi, pall.1217 Vlore.

2. ALBAN AZBI ÇELA , i lindur me 1952 ne Vlore dhe banues ne Rr.Sitki Çiço, pall.6 ap.19 Tirane.

M E O B J E K T : Regjistrimin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufi- ...ORES", si person juridik.




...KATES SE RRETHIT
T I R A N E

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7638, date 19.XI.1992 dhe nenit 33 te Li- gjit Nr.7667, date 28.01.1993, ne ortaket Thodhoraq Pashaj dhe Alban Çela kemi themeluar Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar "JON-ALB-FLORES", me Seli ne lagjen "Rilindja", Rr."Aranit Serbi", pall.1217 Vlore dhe me te dr jte per ta zhvilluar aktivitetin e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj, me kohezgjatje mbi 10 vjet, me kapital theme ltar 100.000 leke i vene me kontributet e barabarta te dy ortakeve nga 50 Thodhoraq Pashaj dhe 50 % Alban Çela, po keshtu do tendahen edhe fitimet 50 % Thodhoraq Pashaj e 50 % Alban Çela, me Administrator Thodhoraq Bendo Pashaj dhe me aktivitet qe konsiston: Ne fushat e projektimit, zbatimit e sherbimit ne siperfaqet e gjelberuara dhe ato urbane ne qytete, komuna dh familjare; import-export per prodhimin dhe tregetimin me shumice e pakice te bimeve dekorative, industriale e medicinale, te farerave te ndryshme tyre etj; import-export per tregetimin me shumice e pakice te artikujve ndryshem bujqesor, blektoral,ushqimor, industrial etj; ne fushen e trans rtit te brendshem e te jashtem per turizem ne qendrat pushuese e klimate ke si dhe transportin e mallrave te permendura me siper me mjetet e shoq rise ose te marra me qera.

Meqense aktiviteti i siperm i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "JON-ALB-FLORES" eshte ne perputhje te plote me legjislacionin ne fuqi t Republikes se Shqiperise, kerkojm nga ana e kesaj gjykate regjistrimin e saj si person juridik.

K E R K U E S I T

1.THODHORAQ PASHAJ 2.ALBAN ÇELA

BANKA KOMBËTARE TREGTARE E SHQIPËRISË
Dëftesë Arkëtimi

Mod. 7

MANDATARKËTIMI
(E brendshme) Nr. 215335

2

100.000 Lekë

( Njeqindemije ) Lekë

Me urdhër
THodhoraq Pashaj

Në kredi
Thodhoraq Pashaj

Numri i llogarise
2456/114

Për
Për SH.P.K.

Vëndi Vlorë date 29.05.1996

Lekë 10
Lekë
Lekë

Sportelisti

Vula e nenshkrimi i arketarit

Shenim: Deftesa pa nenshkrimet dhe vulen perkatese nuk eshte e vlefshme

pergjegjesi i sportelit

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 32/3 fep.

VERTETIM

Me te cilin vertetohet se dokumenti i siperme eshte nje me origjinalin.

Tirane, me 31.05.1996

NOTERE
Kimete Peza

PULLE TAKSE 10 LEKE SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE KIMETE PEZA NOTERE TIRANE

| Viti | Vizita ...e | Derma- ... | Radio sko... | Kopro kultura | kultur Difteri | Vaksi- nim | Vërejtje të organeve inspektoriatit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 199 | 5028 18/10 | 3201 18/10 | 4130 18/10 | 10435 18/10 | | | mandat nr 5236 |
| | | | | | | | Lekë 66 |

[Stamp:] ...Sh. SHËNDETËSISË TIRANË U.F... GUA

15040/2

12.1.2001

11 GEN. 2001

# K E R K E S E

e

THODHORAQ BENDO PASHAJ, lindur me 1950 ne Vlore dhe banues ne Rr.Aranit Serbi, pall.1217 Vlore.

ALBAN AZBI ÇELA, i lindur me 1952 ne Vlore dhe banues ne Rr.Sitki Çiço, pall.6 shk.2 ap.19 Tirane.

M E  O B J E K T: Depozitimin prane regjistrit tregetar, te vendimit te ortakeve te Shoqerise "JON ALB FLORES" shpk Vlore.

GJYKATES RRETHIT

T I R A N E

Ne kerkuesit Thodhoraq Pashaj dhe Alban Çela te dy ortaket e shoqerise "Jon Alb Flores" shpk Vlore, e cila eshte regjistruar si person juridik me vendimin Nr.15040, date 31.05.1996 te Gjykates se rrethit Tirane, me seli ne Rr.Aranit Serbi,pall.1217 Vlore, me kohezgjatje mbi 10 vjet, me kapital themeltar 100.000 leke, me administrator Thodhoraq Bendo Pashaj dhe me aktivitet ne fushen e projektimit, zbatimit e sherbimit ne siperfaqet e gjel beruara dhe ato urbane ne qytet,komuna e familjare etj te parashikuara ne vendimin e me siperm te Gjykates se rrethit Tirane, kerkojme:

Depozitimin e vendimit te ortakeve te perbashket te kesaj shoqerie per te bere plotesimet e me poshteme:

- Shtes aktiviteti i shoqerise "JON ALB FLORES" shpk Vlore ne fushen e ndertimit , punime dheu, sistemime,taracime terrenesh, prodhim material inerte, rere, çakull, mermer, prodhime elementesh te parafabrikuara, beto beton arme, prodhim druri, metalike,plastike, per dyer, dritare, kallepe ndertime civile dhe ekonomike, rikonstruksion godina civile, ekonomike,v shje fasadash etj si dhe mirmbajtje dhe zhvillimi i dekorit ne mjediset urbane.

Selia , kohezgjatja, kapitali dhe administratori i shoqerise nuk ndryshojne.

Meqense kerkesa tone eshte ne perputhje te plote me legjislacionin ne fuqi te Republikes se Shqiperise, kerkojm qe te behen ndryshimet e m siperme ne regjistrin tregetar te kesaj gjykate.

K E R K U E S I T

THODHORAQ PASHAJ

ALBAN ÇELA

Nr.1

# V E N D I M

## I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE "JON ALB FLORES"

## SH.P.K. V L O R E

Sot, me daten 10.01.2001, ne ortaket e Shoqerise "Jon Alb Flores" shpk Vlore, e regjistruar si person juridik me vendimin Nr.15040, date 31.05.1996 te Gjykates se rrethit Tirane, u mblodhem per te analizuar veprimtarin e kesaj shoqerie dhe per te bere ndryshime ne aktivitetin e saj.Ne ortaket Thodhoraq Pashaj dhe Alban Çela pam se:

Nga analiza e bere rezultoi se shoqeria jone e ka zhvilluar veprimtarin e saj konforme legjislacionit te fuqi te Republikes se Shqiperise.

Per realizimin sa me mire te detyrave te kesaj shoqerie si dhe per ecurin e saj te me tejshme;

V E N D O S E M

Te bejm shtes te aktivitetit te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "JON ALB FLORES" ne fushat e ndertimit, punime dheu, sistemime, taracime, terenesh; prodhim materiale inerte, rere, çakull, mermer; prodhime elementesh te parafabrikuara, betoni, beton arme, prodhime druri,metalike,plastike per dyer, dritare, kallepe etj; ndertime civile dhe ekonomike, rikonstruksjon godina civile, ekonomike; veshje fasadash si dhe mirmbajtje dhe zhvillimi i dekorit ne mjediset urbane, etj.

Selia e Shoqerise, kohezgjatja, kapitali, administratori dhe pjesmarrja ne fitimin e Shoqerise nuk ndryshojn.

Kopjen e ketij vendimi per plotesimet e me siperme , mbasi te nenshkruhet nga ortaket e shoqerise dhe te legalizohet tek nje notere, t'i depozitohet ne regjistrin tregetar te Gjykates se rrethit Tirane dhe ne zyren e Tatimeve te rrethit te Vlores.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE "JON ALB FLORES"

THODHORAQ PASHAJ

ALBAN ÇELA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 68 rep.

## V E R T E T I M

Sot, me daten 10.01.2001, ne Dhomen e Noterise Tirane u paraqiten Thodhoraq Pashaj banues ne Vlore dhe Alban Çela banues ne Tirane te dy

KONTRATE PUNE

Sot,me daten 20 Dhjetor 2000,ne qytetin Vlore,prane meje Av.BESNIKE ZENELI,me pune dhe banim ne qytetin Vlore,u paraqiten kerkuesit:

1)Theodhoraq Pashaj,i biri i Bendos dhe i Qafiles i vitlindjes 9.korrik 1950,administrator i firmes "JONALB-FLORES" me qender ne Vlore

2)Evgjeni Baboci,lindur me 25.1.1953,me profesion inxhiniere arkitekte,me banim ne qytetin e Vlores dhe e licensuar me date 24,12.1998, te cilet lidhin kete kontrate:

OBJEKTI I KONTRATES

Mbi marrjen ne pune te znj.Avgjeni Baboçi,inxhiniere arkitekte nga Ndermarrja Private "JONALB FLORES" perfaqsuar nga administratori i saj z.Theodhoraq Pashaj.

KUSHTET E KONTRATES

1.Zoti Theodhoraq Pashaj me kete kontrate pune merr ne pune sot qe lidhet kjo kontrate znj.Evgjeni Baboci, e cila do te punonje me profesionin qe ka inxhiniere arkitekte,per zbatim :

kat.1- Punime dheu,sistemime,taracim terrenesh.

Kat.2/a-Prodhim materiale inerte,rere,cakell,mermer etj.

c-Prodhim elementesh te parafabrikuara,betoni,/b/arme.

g-Prodhim druri,metalike,plastike,per dyer,dritare kallepe etj

Kat.3- Ndertime civile dhe ekonomine.

Kat.10a-Rikonstruksion godina civile,ekonomike,veshje fasadash etj.

14d-Mirembajtje dhe zhvillimi i dekorit ne mjediset urbane.

2.Znj.Evgjeni Baboci pranon me kete kontrate qe te punoje sipas kerkesave te pikes "1" te kesaj kontrate.

3.Palet jane dakort qe zonja Evgjeni Baboci te marre nje page mujore prej 30000( tridhjetemije) leke.

4.Sigurimet shoqerore do te paguhen sipas kerkesave te ligjit

5.Kontrata ka afat nji vjecar,fillon me 20 dhjetor 2000 dhe mbaron me 20 dhjetOr 2001.

Kontrata lexohet dhe pasi gjendet ne rregull firmoset nga te dy palet dhe nga une avokati.

| PUNEDHENES | PUNEMARRES | AVOKAT |
|---|---|---|
| THEODHORAQ PASHAJ | EVGJENI BABOCI | BESNIK ZENELI |

AVOKAT
BESNIK ZENELI
TEL.№063/23678

PULLE TAKSE
50 LEKE
R. SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE
Nr 69 Rep 10.01.2001
VERTETIM
ZTh. Poshg me Nr — Pasaporte
Paraqiti Dokumentin Origj Unë Vërtetoj
që Fotokopja Është një me Origjinalin

NOTERE
LULJETA KONGOLI
Z. 2853

MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT

KOMISIONI I DHENIES SE LICENSAVE PROFESIONALE

L I C E N S E

Z. Evgjeni Baboci , lindur me 25/01/1953, ne Vlore, me profesion inxhiniere arkitekte , diplomuar ne vitin 1976, ne Fakultetin e Inxhinierise se Ndertimit , dega arkitekture, me banim ne Vlore.

Ne baze te kerkeses dhe te dhenave disponuese i jepet license per zbatim dhe rregjistrohet ne rregjistrin themeltar te zbatimit qe nga data 24/12/1998, per kategorite e specifikuara te punimeve:

Per zbatim

Kat.1 - punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh.
Kat.2/a- prodhim materiale inerte , rere, cakell, mermer etj.
c- prodhim elemente te parafabrikuar , betoni, b/arme.
g- prodhime druri, metalike , plastike, per dyer dhe druitare, kallepe, etj.

Kat.3 - ndertime civile dhe ekonomike.

Kat. 10/a - rikonstruksione godina civile,ekonomike , veshje fasadash, etj.

Kat. 14/d- mirembajtja dhe zhvillimi i dekorit ne mjedise urbane.

K U J T I M B E J T A J

ZV/M I N I S T E R